



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2019:187140

Datë: 31.01.2024

Numri i dokumentit: 05264514

C. nr. 433/18

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, Dega Gllogoc - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil me gjyqtarin Astrit Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Mehmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.A, të cilin e përfaqëson i autorizuari i saj Sh.I, kundër të paditurës Komuna e Gllogocit – Drejtoria për Mirëqenie Sociale – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gllogoc, lidhur me kompensimin e pa paguar të shtesave të punës së kujdestarisë, orët e punës natën, orët e punës gjatë festave, orët e punës gjatë vikendeve dhe orët e punës jashtë orarit të punës, vlera e kontestit 3,104.00 € pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datë 26.12.2023 në prani të autorizuarit se paditëses e në mungesë të të paditurës e mori, ndërsa me datën 26.01.2024 e përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET E BAZUAR** kërkesëpadia e paditëses B.A, dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gllogocit – Drejtoria për Mirëqenie Sociale – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gllogoc, që paditëses prej datës 05.12.2015 e deri me datën 31.03.2022 në emër të kompensimit të pa paguar të shtesave për punë gjatë kujdestarisë, orët e punës natën, orët e punës gjatë festave, orët e punës gjatë vikendeve dhe orët e punës jashtë orarit të punës, të ia paguaj shumën prej 2,670.00 € me kamatë ligjore prej 8% në vit prej datës 01.04.2022, dhe kamatën e arritur ligjore prej 8 % në vit për periudhën e lartëcekur prej datës 05.12.2015 e deri me datën 31.03.2022 në shumën prej 434.00 €, në emër të kontributit pensional shumën prej 312 Euro të cilat duhet paguhen në Trustin pensional të paditëses, si dhe për tatimin në pagë shumën prej 297 Euro të cilat duhet paguhen në ATK, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.
- II. OBLIGOHET** e paditura Komuna e Gllogocit – Drejtoria për Mirëqenie Sociale – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gllogoc që paditëses t’ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 814.20 €, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja, në padi dhe kërkesëpadi si dhe në seancat e shqyrtimit kryesor përmes përfaqësuesit të autorizuar të saj ka theksuar se paditësja është punëtore e të paditurës të cilës përveç punës së orarit të rregullt i duhet të mbajë orë pune jashtë orarit të punës, të kujdestarisë, si dhe të punojë në vend të punës me rrezikshmëri të lartë por e paditura lidhur me këtë nuk i ka paguar paditëses orët shtesë në muaj, kujdestarinë javore e as mujore, rrezikshmërinë në punë të cilat janë të

garantuara me kontratën mbi marrëdhënien e punës edhe pse nga e paditura ka kërkuar por e njëjta nuk i është përgjigjur lidhur me këtë çështje. E paditura nuk ka marrë pjesë në asnjë seancë gjyqësore dhe meqenëse e njëjta nuk ka marrë pjesë as në seancën kryesore, i autorizuari i paditëses i ka propozuar gjykatës që seanca kryesore të mbahet në mungesë të të paditurës, pastaj gjykata duke u bazuar në Nenin 423.4 të LPK-së ka marrë aktvendim dhe seancën kryesore e ka mbajtur në mungesë të të paditurës.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor përfaqësuesi me autorizim i paditëses, Sh.I ka deklaruar se: mbetemi në tërësi pranë padisë duke konsideruar se baza e të njëjtës nuk është kontestuese dhe duke u mbështetur në ekspertizën e ekspertit financiar A.B ka bërë precizimin e padisë në kuptimin objektiv ashtu që vlera e padisë do të jetë 2.670.00 Euro kryegjëja si dhe kamata për këtë kryegjë për periudhën gjer në ditën e përpilimit të ekspertizës me datë 31.03.2022 në shumën prej 434.00 Euro, si dhe kamatën ligjore prej 8% në vit pas datës 31.03.2022 gjer në plotëfuqishmërinë e aktgjykimit. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me provat e administruara gjate seancës është vërtetuar baza e padisë duke propozuar që të aprovoj në tërësi padinë si të bazuar dhe të e obligoj të paditurën që të paguaj ndryshimin e pa paguar në të ardhura në kategorinë e kujdestarisë, ndërrimit të natës, të festave, vikendeve dhe punës jashtë orarit të cilat në mënyrë bindëse i ka llogaritur eksperti financiar, ku është vërtetuar se e paditura ka paguar me pak se sa obligimin që e ka pasur ndaj paditëses prej datë 05.12.2015 deri me datë 31.03.2022. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi si dhe në parashtresën të datës 22.12.2023 për seancën e shqyrtimit kryesor të datës 22.12.2023 ka paraqitur deklarin me shkrim, duke theksuar se nuk është kontestuese fakti që paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura ku edhe gëzojnë të drejta nga marrëdhënia e punës siç e parashih legjislacioni në fuqi por kontestuese për institucionin tonë në këtë rast është kompensimi i kërkuar sipas padisë, sepse e njëjta për veçse është kompensuar nga ana e QKMF Hafir Shala në Glllogoc për punën e kryer, njëkohësisht kërkesëpadija e saj është e bazuar në kontratën kolektive Sektoriale të Shëndetësisë tashme të shfuqizuar. Paditëses i janë paguar kompensimet e kërkuara si në padi me të cilën dëshmohet edhe formulari për kompensimet e tjera të orëve të punës i cili gjendet në shkresat e lëndës. Sa i përket kompensimit të rrezikshmërisë vlen të theksohet se kompensimi është bërë në ditë të lira sipas Vendimit Nr.... Sa i përket kompensimit të punëtorëve për punën jashtë pagesë së rregullt sqarojnë se të gjitha këto kompensime të cilat janë objekt shqyrtimi në këtë procedurë janë kompensime të cilat i parashihen në bazë të Ligjit të punës, dhe se askush nuk ka qenë i obliguar as i autorizuar për të punuar më shumë se 174 orë në muaj, andaj duke u bazuar në të lartëcekura i ka propozuar gjykatës që të refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike e zhvilloi procedurën e provave me leximin siç janë: parashtresë për dorëzim të shkresave i datës 20.11.2018, kërkesë e paditëses drejtuar QKMF Glllogoc, Njoftim nga drejtoria për Shëndetësi e KK Glllogoc për paditësen me nr... i datës 2.11.2018, Specifikacion i ditëve të punës gjatë festave dhe kujdestarisë për paditësen B.A dorëzuar nga përfaqësuesi i paditëses me datë 04.03.2020, Ekspertiza e ekspertit të aktuaristikës A.B e datës 10.07.2022, parashtresë e të paditurit e datës 08.07.2022, 07.12.2023, 22.12.2023 dhe 14.12.2023, parashtresë e të paditurit e datës 03.03.2022 së bashku me provat e bashkangjitura në të, Mendimi dhe sqarimi i dhënë nga eksperti A.B në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 26.12.2023, dhe Procesverbalet e datës 04.03.2020 dhe 10.07.2020.

Gjykata pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, bazuar në dispozitën e Nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar, nga këto arsye si në vijim.

Në mes të palëve nuk ishte kontestuese se paditësja ka qenë dhe është në marrëdhënie pune tek e paditura, pasi që këtë nuk e ka mohuar as pala e paditur.

Kontestuese në mes të palëve ishte çështja e pagesës shtesë së paditëses për ditët e punës së natës dhe punën e fundjavave, dite festave për të cilat paditësja ka pretenduar se nuk i janë paguar sipas Kontratës Kolektive Sektoriale të vitit 2015, ndërsa e paditura me anë të njoftimit kishte kundërshtuar pretendimet e paditëses me arsyetimin se ndaj saj e ka përmbushur detyrimin dhe kërkesëpadia e saj është e bazuar ne Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë tashme te shfuqizuara.

Me Nenin 56 par. 2 është përcaktuar se të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si vijon: Sipas par. 2.1 i takon 20 % në orë për kujdestari; sipas par. 2.2 i takon 30 % në orë për punë gjatë natës; sipas par. 2.3, i takon 30 % në orë për punë jashtë orarit; sipas par. 2.4, i takon 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave dhe sipas par. 2.5 i takon 50 % në orë për punë gjatë fundjavës. Po ashtu edhe me Kontratën Kolektive Sektoriale të nënshkruar në mars të vitit 2015 në mes të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK), përkatësisht në tabelën 3 të saj është përcaktuar se punonjësit me koeficientin 4.8 për kujdestarinë e natës duhet të paguhet me 12.10 € shtesë, ndërsa për kujdestarinë 12 orëshe gjatë festave duhet të paguhet shtesa 30.24 €, ndërsa puna gjatë festave, kujdestari 8 orëshe në shumën prej 20.16 €.

Për ta vërtetuar lartësinë e diferencës së kompensimit shtesë për punën e natës dhe të fundjavave për paditësen, gjykata në cilësinë e provës materiale ka nxjerr ekspertizën financiare të cilën e ka punuar eksperti A.B me datë 10.06.2022, detyrat e të cilit janë përcaktuar mbi bazë të vëllimit që ka kërkuar pala paditëse për nxjerrjen e ekspertizës dhe detyrë e ekspertit ka qenë llogaritja e lartësisë së kompensimit shtesë për punë në ditët e festave, punën e natës, orët vazhduese dhe kujdestarinë në fundjavë për paditësen për periudhën 05.12.2015 deri ne muajin 31.03.2022.

Përmes kësaj ekspertize, dhe dëgjimit të ekspertit në seancën e shqyrtimit kryesor 26.12.2023 gjykata vërtetoi se lartësia e kompensimit shtesë nga periudha 05.12.2015 deri më 31.03.2022 është 2,670.00 dhe kamata prej 8 % për periudhën e lartëcekur të pa paguar në shumën prej 434.00 € apo shuma e përgjithshme e tyre prej 3,109.00 € të cilën ekspertizë e ka nxjerrë duke u bazuar në listën e kujdestarisë të cilat i ka marrë në QKMF në Gillogoc, ndërsa përlllogaritjen e ka bërë duke u bazuar në Nenin 56 të Ligjit të Punës, Kontratën Sektoriale të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë (MSH) dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK) 2015-2018 dhe në Kontratën Kolektive Sektoriale të nënshkruar mes FSSHK dhe MSH 2018-2021 për punonjësit me koeficient 4.8 të përshkruar si më lartë. Eksperti për përlllogaritje të shtesave sipas Kontratës Kolektive Sektoriale të vitit 2015 nuk e ka përfshirë muajin prill dhe maj 2018 sepse kjo hapësirë kohore nuk ka qenë e mbuluar me atë kontratë sepse kishte përfunduar në mars të vitit 2018, ndërsa Kontrata Kolektive Sektoriale e nënshkruar në qershor 2018 në mes të palëve të lartcekura kishte filluar të zbatohet prej qershorit të vitit 2018. Eksperti kamatën ligjore për periudhën e lartëcekur e ka llogaritur në normën prej 8% në vit duke u bazuar në Nenin 382 par. 2 të Ligjit nr.04/L-077 të Marrëdhënieve të Detyrimeve.

Në shqyrtimin kryesor eksperti financiar ka theksuar se me ekspertizë ka llogaritur diferencën në shtesën në pagë në mes shtesave të cilat paditësja është dashur të i realizoj konform Ligjit të Punës dhe Kontratës Kolektive dhe atyre shtesave të cilat realisht i ka realizuar sipas të dhënave të cilat pas marrjes së lëndës për ekspertim i ka siguruar nga QKMF në Gillogoc me datën 20.04.2022, duke i krahasuar këto të dhëna e kësaj date mbi shtesat e realizuara të paditëses shihet se të njëjtat janë dukshëm me të ulëta me raport me ato shtesa të cilat është dashur të i realizoj konform formularëve të plotësuar edhe të nënshkruara nga personi përgjegjës i QKMF-së në Gillogoc mbi orët e punës jashtë kujdestarive, gjatë natës dhe festave, ashtu që kompensimi

i pa paguar i shtesave për orët e punës së kujdestarive natën, festave, vikendeve dhe jashtë orarit arrin vlerën prej 2,670.00 € prej datës 05.12.2015 gjer me datën 31.03.2022, kamata ligjore në normën prej 8% në vit për këtë vonesë arrin shumën prej 434.00 € apo shumën e përgjithshme prej 3,104.00 €, si dhe kontributin pensional shumën 312 euro, dhe tatimin në pagë në shumën prej 297 Euro. Gjykata e ka pranuar në tërësi si të besueshme ekspertizën financiare duke vlerësuar se e njëjta është punuar në mënyrë profesionale.

Gjykata duke u nisur nga provat e administruara, gjeti se paditura nuk ia kishte kompensuar paditëses në kryerjen e detyrave të punës si infermiere në QKMF-Gllogoc pagesën shtesë për 05.12.2015 deri në muajin qershor 2021 në pensionimin e paditëses dhe atë punë kujdestarie nate dhe punë të fundjavave nuk i ka paguar paditëses shumën prej 2,670.00 € e as kamatën ligjore prej 8 % për atë periudhë në shumën prej 434.00 € e që arrin shumën e përgjithshme prej 3,104.00 € të parapara në Nenin 56 par.1 dhe par. 2.1 dhe par. 2.5 të Ligjit të Punës, Kontratës Sektoriale të nënshkruar në mes të MSH dhe FSSHK në mars 2015. Gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim t'ia paguajë paditëses kompensimin e shtesave në pagë për punë kujdestarie nate, punë gjatë fundjavave dhe kamatën ligjore prej datës 05.12.2015 deri me datën 31.03.2022 kur është nxjerr ekspertiza, për arsye se në mes të palëve ka ekzistuar raporti juridik. Kurse sipas Nenit 8 par. 2 të LMD-së është përcaktuar se *“Pjesëmarrëset në marrëdhënien e detyrimeve kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”*.

Meqenëse ka lindur e drejta e paditëses për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për realizimin e kompensimit të papaguar të shtesave për punën e natës, punën e fundjavave dhe kamatën për tre muajt e parë të vitit 2018, e njëjti është e legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura. Në bazë të Nenit 245 par. 1 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.

Gjykata i ka vlerësuar edhe pretendimet e përfaqësuesit të të paditurës se Kontrata Kolektive e nënshkruar me datë 11.06.2018 ende nuk gjen zbatim në Republikën e Kosovës për shkak të mungesës së buxhetit, por e konsideron si të paqëndrueshme dhe të paprovuar, ndërsa pretendimeve e të paditurës se e paditura, nuk u takojnë shtesat pasi që kontrata kolektive nuk është në fuqi nuk ia fali besimin pasi që e njëjta me asnjë provë nuk ka arritur të vërtetojë që e paditura, paditëses të i ketë paguar shtesat e lartëcekura. Kjo bazohet edhe në këto dispozita ligjore: Neni 322 paragrafi 1 i LPK-së, përcakton se: *“Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës”*, ndërsa me paragrafin 2 të ligjit dhe nenit të njëjtë përcaktohet se *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*.

Meqenëse e paditura ka rënë në vonesë lidhur me përmbushjen e detyrimit ndaj paditëses, gjykata me kërkesën e paditëses dhe në bazë të Nenit 382 par. 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e detyroj të paditurën që paditësit në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën ligjore prej 8% në vit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marr në bazë të Nenit 452.1 lidhur me Nenin 463.1 dhe 2 të LPK-së ashtu që është detyruar e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën prej 814.20 € dhe atë: 540.00 € për përfaqësim nga ana e avokatit në 5 seanca gjyqësore ku tri seanca të mbajtura nga 135,20 Euro dhe dy seanca të shtyera secila nga 67.20 Euro, shumën prej 104 € për padi, shumën prej 150 € në emër të shpenzimeve për ekspertizën financiare dhe shumën prej 20 € në emër të taksës gjyqësore për padi.

Nga sa u parashtrua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC,
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr. 433/2018, datë 26.01.2024**

**Gj y q t a r i
Astrit Gashi**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:187140
Datë: 31.01.2024
Numri i dokumentit: 05264514